



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep: <b>DPK/DMP</b>	Nr. Prot: <b>03-4680/12</b>
Proj. Nr: <b>02</b>	Prot. No: <b>31.12.2012</b>
PRISHTINË	



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

Regj. Nr. 5239/2012

**Gjykata Komunale për Kundervajtje në Viti**, Gjyqtari Alush Sinani dhe sekretarja juridike Magribe Bislimi, duke vendosur në procedurën kundervajtse kundër Kabil Hajdari nga f, Remnik K. Viti, për shkak të veprës kundervajtse, të paraparë dhe sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1.5, lidhur me dispozitat e nenit 15 paragrafi 3, të Ligjit Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar Nr; 04/L-050, aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, e konform nenit 30, 73, 195 dhe 198 paragrafi 1 pika 8, të Ligjit mbi Kundervajtjet, me datën 11. 12. 2012, shpallë këtë:

### AKTVENDIM

PEZULLOHET, procedura kundervajtëse, konform nenit 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundervajtjet. e inicuar me kërkesen me nr. 01-3646/12, e datës 11.10. 2012, nga ana e Agjensi Kundër Korupsion, Dep; Parandalimit në Prishtinë, për shkak të veprës kundervajtse, të paraparë dhe sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1.5, lidhur me dispozitat e nenit 15 paragrafi 3, të Ligjit Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar Nr; 04/L-050, aprovuar nga Kuvendi i Kosovës,

Kundër Kabil Kadri Hajdari, i lindur me 20.12.1962, në f, Remnik K. Viti, ku edhe tani jeton, i punësuar menagjer në KRM "Higjena" në Gjilan-Njësia punuse në Viti, i martuar baba i tre fëmijëve, të kryer fakultetin, me gjendje të dobët ekonomike, kinse deri tani i pa denuar, shqiptar shtetas i Republikës Kosovës

### Arsyetim

**Agjensi Kundër Korupsioni, dep; Parandalimit në Prishtinë**, ka paraqitur kërkesen me nr. 01-3646/12, e datës 11.10. 2012, për fillimin e procedurës kundervajtës kundër të lartshenuar, për shkak të veprës kundervajtse, të paraparë dhe sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1.5, lidhur me dispozitat e nenit 15 paragrafi 3, të Ligjit Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar Nr; 04/L-050, aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të ndëshkohet sipas Ligjit .

Gjykata shqyrtoi kërkesen dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme dhe aprovoj fillimin e procedurës kundervajtse nda të lartshenuarit, lidhur me veprën kundervajtse të lartshenuar.

Gjykata me qëllim t'vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ftoi dhe mori në pyetje Kabil Hajdarin, në cilësinë e të pandehurit, i cili në deklarin e tij të dhënë në Gjykatë me dt, 04.12.2012, mohoi se ka kryer veprën kundervajtse e cila i vehe në barrë dhe kërkoi të lirohet nga përgjegjësia. I njëjti thekson se në cilësi të këshilltarit komunal pranë KK. Viti, nga zyrtarët komunal në Viti ka pranuar formularin për deklarimin e pasurisë me date, 12.03.2012, plotësimin e formularit e ka bërë me date 16.03.2012 dhe të njëjtin e ka dorëzuar tek zyrtari kompetent komunal për personel, pastaj nga zyrtari komunal formulari i tij dhe kolegëve të tij është dorëzuar me date 29.03.2012, në Prishtinë në Agjensionin Kundër Korupsionit. Sa i përket faktit se ka qenë i obliguar që të plotësoj formularin në cilësi të menagjerit në KRM "Higjena" në Gjilan, Njësia punuse në Viti, thekson se asnjëherë nga askush nuk ka qenë i njoftuar dhe as që ka pranuar ndonjë njoftim apo kërkesë, ndërsa lidhur me kërkesen e dërguar nga Agjensionin

03-4680/12/02  
fengj

Kundër Korupsionit, me datë 22.08.2012, mohon se të njejtën e ka pranuar personalisht, sepse e njejtë kërkesë është adresuar në KRM "Higjena" në Gjilan dhe njejtë është pranuar nga një person, e që nënshkrimi i tij është i pa lexushëm dhe nuk e dinë kush është personi që e ka pranuar dergesen nga ana e AKK-së, kjo vrehet edhe me dallimin e madh në mes të nënshkrimit tim origjinal, i cili është i nënshkruar në formularin e deponuar, me datë 29.03.2012, në AKK-ë, pastaj në formular shihet qartë se vendi i punës nuk është në Gjilan, por është në Njësinë punuese në Viti, ndërsa shkresa është adresuar në Gjilan gabimisht, gjithashtu në formular ka qenë i deponuar edhe nr, telefonit personal, e që askush në këtë numër nuk e ka kontaktuar, në fund thekson se nuk ka pas asnjë arsye, përse mos të plotëson formularin e kërkuar nga Agjensioni dhe se të njejtat shenime që i ka deponuar-paraqitur, në cilësi të këshilltarit komunal, kishte me i deponuar-paraqitur edhe në formularin e kërkuar rishtas nga ana e Agjensionit pa kurafë ndryshimesh, për këtë arsye kërkon që ndaj tij të pezullohet procedura kundervajtse, sepse konsideron se gabimi është tek zyrtari i AKK-së, i cili adresimin e shkresave nuk e ka bërë në adresën e duhur siq shkruan në formularin e deponuar me dt, 29.03.2012, e që adresa është KRM "Higjena" Gjilan – Viti, rruga "Dëshmorët e Kombit".

Gjyqtari pas shiqimit të shkresave të lëndës, deklaratës së Kabil Hajdarit, regjistrimin mbi dorzimin e formularve nga zyrtari komunal në Viti, analizimit të kërkesës së datës 22.08.2012, formularin e deponuar me datë 29.12.2012 në emër të Kabil Hajdarit, në cilësi të këshilltarit komunal në Viti, fletëkthesa postale mbi dorzimin e kërkesës dhe faktin se Agjensioni Kundër Korupsionit edhe kërkesën për inicimin e procedurës kundervajtse, e ka derguar në Gjykatën komunale për Kundervajtje në Gjilan e jo në Viti, erdhi në përfundim se nuk ka prova bindëse se i Kabil Hajdari, ka kryer veprën kundervajtse që u veht në barrë, andaj Gjyqtari vendosi të pezulloj procedurën kundervajtse, konform nenit 198 paragrafi 1 pika 8, të LMK-së, ndaj të lartëshenuarit.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË VITI

Regj. Nr. 5239/2012

Me datën 11. 12. 2012

Sekretarja juridike,  
Magribe Bislimi

Gjyqtari,  
Alush Sinani

**KSHILLA JURIDIKE:** Kunder këtij aktvendimi nga ana e palëve mund të paraqitet ankesë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit dhe ate Gjykatës së Lartë për Kundervajtje në Prishtinë, ankesa dërgohet përmes kësaj Gjykate.